

# HISTORIA XI

## Hyrje

Në klasën XI në lëndën e historisë synohet që nxënësit të ngrisin nivelin e informacioneve për rrjedhojat e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore gjatë historisë dhe zhvillimin e shkathtësive për përdorimin e tyre në jetën e përditshme. Pretendohet që përmes lëndës së historisë të mundësohet ngritja e gjithanshme e personalitetit të nxënësve si në aspektin shoqëror, politik, kulturor, fetar, human etj.

## GJIMNAZI I PËRGJITHSHËM

### Qëllimet

*Programi mësimor i lëndës së historisë për klasën XI ka për qëllim:*

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të kuptuar dhe për të analizuar ligjshmëritë e proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore nga mesjeta e deri në fundin e Revolucionit Francez Borgjez.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të analizuar dhe për të krahasuar mënyrën e jetesës, të menduarit, zhvillimin ekonomik, politik, shoqëror, të arriturat shkencore nga mesjeta dhe koha e re, me të sotmen.
- Aftësimin e nxënësve për të analizuar rolin e personaliteteve që kanë lënë gjurmë në histori si dhe të veprave të mëdha që ndikuan në kahet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.
- Zhvillimin e të gjykuarit drejt për shkaqet, rrjedhojat dhe pasojat e luftërave, ndryshimet shoqërore që sollën revolucionet etj.

### Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë

*Nxënësit duhet të jenë në gjendje:*

#### *Të njohin*

- Zhvillimet e përgjithshme shoqërore dhe ligjshmëritë e këtyre zhvillimeve prej Mesjetës deri te Revolucioni Borgjez Francez.

### ***Të kuptojnë***

- Domethëniet e termave historikë për këto periudha historike
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore prej Mesjetës e deri te Revolucioni Francez Borgjez.

### ***Të identifikojnë***

- Personalitetet më të shquara politike, kulturore, arsimore, shkencore etj. të këtyre periudhave nga historia kombëtare, rajonale e botërore.

### ***Të analizojnë***

- Dallimet e periudhave historike të feudalizmit të zhvilluar dhe të kapitalizmit të hershëm.
- Faktorët që ndikuan në zhvillimet e proceseve shoqërore.

### ***Të vlerësojnë***

- Rolin e shteteve dhe të institucioneve vendore e ndërkombëtare në avancimet e proceseve shoqërore.
- Ngjarjet historike që ndikuan negativisht në zhvillimin shoqëror, në mënyrë që ato të mos përsëriten.

### ***Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera***

- Vlerësimin e të arriturave të shoqërisë njerëzore gjatë periudhave të feudalizmit dhe të kapitalizmit të hershëm.
- Sendërtojnë ndjenjën dhe nevojën e mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe kultivimit të marrëdhënieve demokratike.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri. Për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, ruajtjen e monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj. si pasuri kombëtare e njerëzore në përgjithësi.

**GJIMNAZI I PËRGJITHSHËM 2 x 35 = 70 orë në vit (52 orë zhvillim, 4 orë në dispozicion dhe 14 orë përsëritje)**

Kategoria	Nënkategoria	Përmbajtjet programore	Rezultatet e pritura	Ndërlidhjet programore
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>2. Zbulimet e mëdha gjeografike</b>	<p><i>Nxënësit mësojnë për :</i></p> <p><b>Zbulimet e mëdha gjeografike</b> Rrethanat ekonomike e politike që ndikuan në zbulimet e mëdha gjeografike</p> <p>Zbulimet gjeografike dhe rrjedhojat e këtyre zbulimeve</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p><i>Nxënësit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallojnë faktorët që ndikuan për zbulimet e mëdha gjeografike</li> <li>- Veçojnë shtetet dhe personalitetet kryesore që organizuan ekspeditat dhe krijuan kolonitë e tyre</li> <li>- Janë në gjendje të shprehin qëndri - met e veta për rëndësinë dhe ndikimin e këtyre zbulimeve në zhvillimet në Evropë dhe në botë</li> </ul>	Gjeografinë, fizikën, astronominë, letërsinë, artin, i ekonominë etj
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>3. Evropa gjatë kohës së re</b>	<p><b>Evropa nga shekulli XVI deri në mesin e shekullit XVII</b> Zhvillimet kryesore në vendet kryesore evropiane të asaj kohe si: Shtetin Habsburg, Gjermaninë, Vendet e Ulëta (Holandën), Francën, Anglinë e Spanjën. Ekonomia evropiane gjatë shekujve XVI – XVII. Lufta civile dhe revolucioni anglez 1688.</p> <p><b>(8 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjykojnë në mënyrë kritike për zhvillimet dhe ngjarjet shoqërore, ekonomike e politike në vendet kryesore evropiane</li> <li>- Dallojnë format organizative të shteteve kryesore evropiane dhe kontradiktat mes tyre</li> <li>- Shpjegojnë rrjedhojat e luftës civile dhe të revolucionit anglez</li> </ul>	Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, letërsinë etj.

<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>1.Rilindja, reforma dhe kundërreforma</b></p>	<p><b>Reforma fetare katolike</b>  Reformacionin.  Kundërreformacionin katolik.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<p>- Kuptojnë për ndikimin dhe rolin që kishte kisha në mesjetë</p> <p>- Arsyetojnë shkaqet e paraqitjes së protestantizmit në Gjermani e në vende të tjera dhe shpjegojnë veprimet e kundërreformacionit katolik</p>	<p>Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, letërsinë, artin etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b></p>	<p><b>Kultura, shkenca</b>  Kultura dhe të arriturat shkencore evropiane nga shekulli XVI deri në mesin e shekullit XVII.</p> <p><b>(1 orë)</b></p>	<p>- Gjykojnë në mënyrë kritike për zhvillimet kulturore e shkencore në vendet kryesore evropiane</p>	<p>Gjeografinë, artinë, filozofinë, letërsinë etj.</p>

<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë shekujve XVI – XVII</b>  Rregullimin shtetëror e administrativ të Perandorisë Osmane dhe ngjarjet kryesore që kanë të bëjnë me këtë perandori.</p> <p>Popujt e Ballkanit gjatë atyre shekujve</p> <p><b>(2 orë )</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahasojnë formën e organizimit shtetëror e administrativ të Perandorisë Osmane dhe të vendeve evropiane.</li> <li>- Identifikojnë ngjarjet kryesore që kanë të bëjnë me Perandorinë Osmane në atë kohë.</li> <li>- Mund të shpjegojnë gjendjen e përgjithshme të popujve të Ballkanit në atë kohë dhe raportet e tyre me Perandorinë Osmane.</li> </ul>	<p>Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, sociologjinë, filozofinë artin, letërsinë etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Shqiptarët pas rënies së shtetit të Skënderbeut e deri në fundin e shekullit XVII</b>  Humanizmi dhe Rilindja te shqiptarët.</p> <p>Forcimi i sundimit osman, ndarja administrative e trojeve shqiptare (sistemi timar).</p> <p>Qëndresa e popullit shqiptar pas rënies së shtetit të Skënderbeut.</p> <p>Emigrimet e popullit shqiptar pas vdekjes së Skënderbeut.</p> <p>Kuvendet shqiptare e ballkanike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallojnë dhe çmojnë përhapjen e ideve humaniste dhe humanistët e shquar shqiptarë të asaj kohe.</li> <li>- Mund të interpretojnë karakteristikat e administrimit osman të tokave shqiptare.</li> <li>- Mund të gjykojnë për pasojat e vdekjes së Skënderbeut dhe emigrimin e popullit shqiptar.</li> <li>- Analizojnë bashkëpunimin e popujve ballkanikë, kuvendet dhe kryengritjet e tyre antiosmane.</li> <li>- Nxjerrin përfundime nga</li> </ul>	<p>Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, artin, muzikën, letërsinë, gjuhën etj.</p>

		<p>Lëvizjet çlirimtare shqiptare në fund të shekullit XVII.</p> <p>Ndryshimet e strukturës fetare të shqiptarët.</p> <p>Zhvillimi i qyteteve shqiptare.</p> <p>Ardhja dhe vendosja e grupeve të tjera etnike në trojet shqiptare (turqve, ebrejve, romëve etj.)</p> <p><b>(9 orë)</b></p>	<p>bashkëpunimi i shqiptarëve me vendet evropiane dhe kryengritja e tyre për liri e udhëhequr nga Pjetër Bogdani.</p> <p>- Në mënyrë të argumentuar arsyetojnë ndryshimin e strukturës fetare të shqiptarët.</p> <p>- Veçojnë zhvillimet e qyteteve gjatë asaj kohe.</p> <p>- Identifikojnë prejardhjen dhe kohën e ardhjes së grupeve etnike (turqve, ebrejve, romëve etj.) në trojet shqiptare dhe vlerësojnë ndikimet reciproke me popullsinë vendëse.</p>	
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b>	<p><b>Arsimi, kultura dhe e drejta zakonore</b></p> <p>Zhvillimi i arsimit, i kulturës dhe i artit të shqiptarët.</p> <p>E drejta zakonore shqiptare – Kanuni i Lekë Dukagjinit.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<p>- Veçojnë zhvillimet e arsimit, kulturës, artit të shqiptarët gjatë asaj kohe.</p> <p>- Në mënyrë të argumentuar mund të diskutojnë për të drejtën zakonore të shqiptarët dhe të gjykojnë në mënyrë kritike rolin dhe rëndësinë e Kanunit të Lekë Dukagjinit.</p>	Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, artin, muzikën, letërsinë, gjuhën etj.
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë kohë së re</b>	<p><b>Revolucioni amerikan dhe formimi i SHBA –ve</b></p> <p>Krijimi i kolonive angleze në</p>	<p>- Analizojnë rrethanat e krijimit të kolonive angleze në Amerikën e Veriut dhe raportet e tyre me mbretërinë</p>	Gjeografinë, edukatën qytetare,

		<p>Amerikën e Veriut.</p> <p>Shpallja e pavarësisë së SHBA-ve.</p> <p>Kushtetuta amerikane (1787).</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p>angleze, arsyetojnë kryengritjen e këtyre kolonive për liri dhe shkëputje nga Anglia.</p> <p>- Çmojnë aktin e shpalljes së pavarësisë së SHBA –ve si e drejtë për vetëvendosje dhe liri.</p> <p>- Vlerësojnë veprimtarinë e patriotëve amerikanë si Xhorgj Uashingtoni etj. në luftën për pavarësinë e SHBA-ve.</p> <p>- Çmojnë rëndësinë e Kushtetutës amerikane (1787), në organizimin dhe funksionimin e shtetit dhe ndikimin e saj në avancimin e të drejtave të njeriut në SHBA dhe në botë.</p>	<p>shkencat ju - ridike, artin, letërsinë etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>3. Evropa gjatë kohës së re</b></p>	<p><b>Evropa nga gjysma e shekullit XVII dhe gjatë shekullit XVIII</b></p> <p>Revolucioni industrial në Angli.</p> <p>Zgjerimet kolonialiste evropiane në botë.</p> <p>Gjermania, Austria, Rusia, Italia, Spanja nga gjysma e shekullit XVII dhe gjatë shekullit XVIII.</p> <p>Franca nga gjysma e shekullit XVII dhe gjatë shekullit XVIII, deri në</p>	<p>- Shpjegojnë arsyet e shpërthimit të revolucionit industrial në Angli dhe ndikimet e tij në Evropë.</p> <p>- Dallojnë zgjerimet kolonialiste evropiane në botë.</p> <p>- Dallojnë dhe komentojnë organizimin shoqëror, ekonomik, politik, kulturor të vendeve kryesore evropiane.</p>	<p>Gjeografinë, ekonominë, filozofinë, sociologjinë, letërsinë, artin, muzikën, teknologjinë etj</p>

		fillimin e Revolucionit Borgjez. <b>(8 orë)</b>		
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b>	<b>Idetë e reja, shkenca dhe kultura</b> Iluminizmi dhe përhapja e tij.  Zhvillimi i kulturës, i shkencës dhe i teknikës në Evropë nga gjysma e dytë e shekullit XVII dhe gjatë shekullit XVIII.  <b>(2 orë)</b>	- Çmojnë shfaqjen dhe përhapjen e ideve iluministe dhe ndikimin e tyre në të arriturat e gjithmbarshme të shoqërisë njerëzore.  - Identifikojnë dhe klasifikojnë, sipas rëndësisë, të arriturat kryesore kulturore, teknike e shkencore evropiane të asaj kohe.	Gjeografinë, filozofinë, sociologjinë, letërsinë, artin, muzikën, teknologjinë etj



<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë shekullit XVIII</b>  Perandoria Osmane gjatë shekullit XVIII.</p> <p>Popujt e Ballkanit gjatë shekullit XVIII.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<p>- Mund të sqarojnë në mënyrë të argumentuar gjendjen e Perandorisë Osmane dhe shenjat e dobësimit të saj.</p> <p>- Vlerësojnë përpjekjet e popujve ballkanikë për çlirim nga sundimi osman.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, artin etj.</p>
-----------------------------	---	---	--	---

		<p><b>Shqiptarët gjatë shekullit XVIII</b> Fillet e pashallëqeve shqiptare.</p> <p>Pashallëku i Shkodrës.</p> <p>Pashallëku i Janinës.</p> <p>Marrëdhëniet e pashallëqeve shqiptare me vendet evropiane.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxjerrin përfundime për gjendjen e atëhershme të Perandorisë Osmane dhe rrethanat e krijimit të pashallëqeve shqiptare.</li> <li>- Analizojnë gjithanshëm zhvillimet në Pashallëkun e Shkodrës dhe të Janinës.</li> <li>- Në mënyrë kritike gjykojnë rolin e personaliteteve kryesore të asaj kohe si: Ali Pashë Tepelena, Kara Mahmut Pashë Bushatliu etj.</li> <li>- Krahasojnë marrëdhëniet e pasha-llëqeve shqiptare me vendet e tjera evropiane.</li> </ul>	<p>Gjeografinë, ekonominë, letërsinë, artin etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b></p>	<p><b>Arsimi, shkenca, kultura</b> Zhvillimi i arsimit, i shkencës, i kulturës dhe i artit të shqiptarët.</p> <p>Monumentet kulturore-historike të periudhës osmane në trojet shqiptare.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veçojnë zhvillimet shkencore, teknike, arsimore, kulturore dhe ato në art në atë kohë.</li> <li>- Identifikojnë monumentet kulturore-historike, kryesore, të periudhës osmane në trojet shqiptare.</li> <li>- Vlerësojnë ndikimin e tyre në jetën e përditshme të popullit tonë.</li> </ul>	<p>Gjeografinë, letërsinë, artin etj.</p>

	<p><b>3. Evropa gjatë kohës së re</b></p>	<p><b>Revolucioni Francez Borgjez</b></p> <p>Rrethanat e fillimit të Revolucionit.</p> <p>Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit, Shpallja e Repu – blikës.</p> <p>Diktatura Jakobine.</p> <p>Rëndësia dhe ndikimi i Revolucionit Borgjez në zhvillimet e gjithë - anshme të shoqërisë njerëzore.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësojnë arsyet e shpërthimit të Revolucionit.</li> <li>- Prezantojnë me fakte zhvillimet kryesore të Revolucionit. Gjykojnë rolin e personaliteteve kryesore të Revolucionit.</li> <li>- Konkludojnë për rëndësinë e Revolucionit në përgjithësi dhe për Deklaratën e të Drejtave të Njeriut në veçanti.</li> <li>- Vlerësojnë ndikimet pozitive që pati ky Revolucion në të ardhshmen e Francës, të Evropës dhe në tërë botën.</li> </ul>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, filozofinë, sociologjinë, letërsinë, artin etj</p>
--	---	--	--	---

**Vërejtje:** 4 orë mësimore mbeshin në dispozicion të arsimtarit që, sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve, të kenë mundësi të zgjedhin ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni, vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.



## **GJIMNAZI I GJUHËVE**

### **Qëllimet**

#### ***Programi mësimor i lëndës së historisë për klasën XI ka për qëllim:***

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të kuptuar dhe për të analizuar ligjshmëritë e proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore në periudhën historike nga viti 1875 e deri në ditët e sotme.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të analizuar dhe për të krahasuar mënyrën e jetesës, të menduarit, zhvillimin ekonomik, politik, kulturor, shoqëror, të arriturave shkencore nga gjysma e dytë e shekullit XIX dhe gjatë shekullit XX.
- Aftësimin e nxënësve për të analizuar rolin e personaliteteve që kanë lënë gjurmë në histori dhe veprave të mëdha që ndikuan në kahet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.
- Zhvillimin e të gjykuarit drejt për shkaqet, rrjedhojat dhe pasojat e luftërave, ndryshimet shoqërore që sollën revolucionet etj.

### **Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë**

#### ***Nxënësit duhet të jenë në gjendje:***

##### ***Të njohin***

- Ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme të kësaj periudhe nga historia e shqiptarve të Ballkanit dhe botës.

##### ***Të kuptojnë***

- Domethëniet e termave historikë për këtë periudhë.
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore në periudhën historike nga viti 1875 e deri në ditët e sotme.

##### ***Të analizojnë***

- Karakteristikat e zhvillimeve historike nga gjysma e dytë e shekullit XIX dhe gjatë shekullit XX.
- Faktorët që ndikuan në zhvillimet e proceseve shoqërore.

- Të analizojnë raportin e ideve dhe rrymave politike që u paraqitën në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe gjatë shekullit XX (si p.sh.: komunizmi, socializmi, fashizmi, nacizmi, të painkuadruarit etj.)

### ***Të vlerësojnë***

- Rolin e shteteve dhe të institucioneve vendore e ndërkombëtare në avancimet e proceseve shoqërore.
- Ngjarjet historike që ndikuan negativisht në zhvillimin shoqëror, në mënyrë që ato të mos përsëriten.

### ***Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera***

- Vlerësimin e të arriturat dhe vlerat humane të shoqërisë njerëzore gjatë kësaj periudhe historike.
- Sendërtojnë ndjenjën dhe nevojën e mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe kultivimit të marrëdhënieve demokratike.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, ruajtjen e monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj. si pasuri kombëtare e njerëzore në përgjithësi.

<b>GJIMNAZI I GJUHËVE      2 x 35 = 70 orë në vit (55 orë zhvillim, 4 orë në dispozicion dhe 11 orë përsëritje)</b>				
<b>Kategoria</b>	<b>Nënkategoria</b>	<b>Përmbajtjet programore</b>	<b>Rezultatet e pritura</b>	<b>Ndërlidhjet programore</b>
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>3. Evropa gjatë kohës së re</b>	<p><i>Nxënësit mësojnë për:</i></p> <p><b>Evropa në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX</b></p> <p>Shtetet kryesore evropiane të asaj kohe (Gjermaninë, Francën, Anglinë, Italinë, Austro – Hungarinë. Shtetet e Ballkanit, Serbinë, Malin e Zi, Greqinë.</p> <p><b>(5 orë)</b></p>	<p><i>Nxënësit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë rrethanat e gjithmbarshme evropiane të asaj kohe.</li> <li>- Analizojnë organizimet shoqërore e shtetërore të shteteve kryesore në atë kohë</li> <li>- Gjykojnë për zhvillimet ekonomike, kulturore dhe ndikimet e tyre në progresin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore.</li> </ul>	Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë, filozofinë, letërsinë, teknologjinë etj.
	<b>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë kohës së re</b>	<p><b>Bota në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX</b></p> <p>Rusinë, SHBA-të, dhe vendet e Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë rrethanat e gjithmbarshme botërore të asaj kohe.</li> <li>- Analizojnë organizimet shoqërore e shtetërore të shteteve kryesore në atë kohë</li> </ul>	Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë, filozofinë, letërsinë, teknologjinë etj.
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b>	<b>Ballkani dhe shqiptarët në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX</b>	- Kuptojnë rrethanat e gjithmbarshme ballkanike të asaj kohe.	Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë,

		<p>Shtetet e Ballkanit, Serbinë, Malin e Zi, Greqinë.</p> <p>Krizën Lindore të viteve `70, të shekullit XIX dhe rrezikun që kanë për copëtimin e trojeve shqiptare</p> <p>Themelimin e organizatave (lidhjeve) shqiptare, Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës dhe veprimtarinë e tyre.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>- Analizojnë organizimet shoqërore e shtetërore të shteteve kryesore ballkanike në atë kohë.</p> <p>-Identifikojnë rrezikun e copëtimit të trojeve shqiptare.</p> <p>- Arsyetojnë themelimin e Lidhjes së Prizrentit dhe të Pejës dhe vlerësojnë veprimet e tyre.</p>	<p>filozofinë, letërsinë, teknologjinë etj.</p>
<b>V. KOHA BASHKËKOHORE</b>	<b>5. Të arriturat në kulturë, shkencë e teknike gjatë shekullit XX</b>	<p><b>Arsimi e kultura në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX</b></p> <p>Arsimin e kulturën të shqiptarët.</p> <p><b>(1 orë)</b></p>	<p>- Identifikojnë zhvillimet arsimore e kulturore të popullit shqiptar në atë kohë.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, gjuhën, artin, muzikën etj</p>
<b>V. KOHA BASHKËKOHORE</b>	<b>1. Bota në fillim të shekullit XX</b>	<p><b>Shqiptarët në fillim të shekullit XX</b></p> <p>Lëvizjen kombëtare shqiptare 1908 –1912.</p> <p>Shpalljen e Pavarësisë së shtetit shqiptar dhe veprimtarinë e Qeverisë së Ismail Qemalit, qeverisjen e Princit Vidit.</p> <p>Lufta për çlirim e bashkim kombëtar në Kosovë e vise të tjera 1912 – 1914.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>- Kategorizojnë veprimet e lëvizjes kombëtare gjatë viteve 1908-1912.</p> <p>- Veçojnë rëndësinë e shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar dhe gjykojnë veprimtarinë e Qeverisë së Ismail Qemalit dhe të Princit Vidit</p> <p>- Arsyetojnë luftën për çlirim e bashkim kombëtar të Kosovës dhe</p>	<p>Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë, filozofinë, letërsinë, artin, teknologjinë etj.</p>



			viseve tjera	
<b>V. KOHA BASHKËKO HORE</b>	<b>1. Bota në fillim të sheku llit XX</b>	<p><b>Lufta e Parë Botërore</b></p> <p>Rrethanat pararendëse të L.P.B., zhvillimet kryesore të luftës gjatë viteve 1914-1916 dhe 1917-1918.</p> <p>Revolucioni Socialist i Tetorit në Rusi.</p> <p>Gjendjan e shqiptarëve gjatë L.P.B. 1914 - 1918</p> <p><b>(4 orë )</b></p>	<p>- Analizojnë rrethanat ndërkombëtare që quan në shpërthimin e L.P.B.</p> <p>- Dallojnë frontet dhe betejat kryesore të luftës si dhe veprimet politike e diplomatike të shteteve kryesore.</p> <p>- Shpjegojnë për jetën e përditshme të njerëzve gjatë asaj periudhe.</p> <p>- Vlerësojnë ndikimet që pati për njerëzimin Revolucionit Socialist i Tetorit.</p> <p>- Janë në gjendje të analizojnë për pozitën e popullit shqiptar gjatë L.P.B. dhe për veprimet e Fuqive të Mëdha në tokat shqiptare.</p>	Gjeografinë, ekonominë, sociologjinë, kiminë fizikë, biologjinë, matematikën, letërsinë, artin etj.
<b>V. KOHA BASHKËKO HORE</b>	<b>2. Bota midis Dy Luftërave Botërore</b>	<p><b>Bota mes dy luftërave botërore</b></p> <p>Ndryshimet e reja në hartën gjeopolitike të Evropës.</p> <p>Gjendjen e gjithmbarshme në shtetet kryesore evropiane (Britani të Madhe, Francë, Gjermani, Itali)</p> <p>SHBA-të, BRSS-në Ballkanin, Azinë,</p>	<p>- Veçojnë cilat shtete të reja u krijuan dhe cilat shtete u shpërbënë në Evropë pas L.P.B.</p> <p>- Krahasojnë organizimin shoqëror e shtetëror të vendeve evropiane (Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Itali), Ballkanit, SHBA-ve BRSS, vendeve të Azisë,</p>	Gjeografinë, ekonominë, letërsinë, artin, teknologjinë etj.

		Afrikën dhe Amerikën Latine.  <b>(9 orë)</b>	Afrikës dhe Amerikës Latine.	
<b>V. KOHA BASHKËKO HORE</b>	<b>5. Të arriturat në kulturë, shkencë e në technikë gjatë shekullit XX</b>	<b>Shkenca, teknika</b> Zhvillimet e shkencës dhe teknikës në botë në përgjithësi  <b>(1 orë)</b>	- Analizojnë mënyrën e jetesës së njerëzve në këtë periudhë.  - Veçojnë të arriturat kryesore shkencore e teknike dhe ndikimin e tyre në jetën e njerëzve.	Gjeografinë, ekonominë, letërsinë, artin, teknologjinë etj.
	<b>2. Bota midis dy luftërave botërore</b>	<b>Shqiptarët midis dy luftërave botërore</b> Shtetin Shqiptar gjatë viteve 1918 –1924.  Shqipërinë gjatë sundimit të A. Zogut 1925 –1939.  Pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë SKS gjatë viteve 1918-1924 dhe 1925-1941  <b>(4 orë)</b>	- Janë në gjendje të bëjnë analizë të përgjithshme të gjendjes së Shqipërisë si në aspektin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar për periudhat 1918- 1924 dhe 1925 -1939.  - Vlerësojnë raportin e forcave po- litike shqiptare, sidomos në ngja- rjet e vitit 1924.  - Gjykojnë drejt rolin e A. Zogut gjatë periudhës së sundimit të tij.  - Kuptojnë pozitën e shqiptarëve në Mbretërinë SKS gjatë periudhës 1918 - 1941 dhe veprimtarinë e personaliteteve kryesore të lëvizjes kombëtare.	Gjeografinë, ekonominë letërsinë, artin etj.

<b>V. KOHA BASHKËKO- HORE</b>	<b>5. Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX</b>	<b>Arsimi e kultura midis dy luftërave botërore</b> Zhvillimin e arsimit dhe kulturës te shqiptarët gjatë asaj kohe.  <b>(1 orë)</b>	- Janë në gjendje të shpjegojnë për zhvillimet arsimore e kulturore të popullit shqiptar në atë kohë	Gjeografinë, ekonominë letërsinë, artin etj.
	<b>3. Bota gjatë Luftës së Dytë Botërore</b>	<b>Lufta e Dytë Botërore</b> L.D.B. gjatë viteve 1939-1943.  L.D.B. gjatë viteve 1943-1945.  Pasojat e L. D. B.  <b>(3 orë)</b>	- Bëjnë dallimin e qëndrimeve të Fuqive të Mëdha në prag të fillimit të L.D.B.  - Mund të përvijojnë veprimet kryesore luftarake dhe frontet kryesore të L.D. B.  - Analizojnë personalitetet kryesore dhe rolin e tyre gjatë luftës.  - Kuptojnë gjendjen e popullsisë civile, jetën e përditshme, në ato kohë të vështira.  - Gjykojnë për pasojat që solli L.D.B. për njerëzimin në përgjithsi dhe për Holokaustin në veçanti.	- Bëjnë dallimin e qëndrimeve të Fuqive të Mëdha në prag të fillimit të L.D.B.  - Mund të përvijojnë veprimet kryesore luftarake dhe frontet kryesore të L.D. B.  - Analizojnë personalitetet kryesore dhe rolin e tyre gjatë luftës.  - Kuptojnë gjendjen e popullsisë civile, jetën e përditshme, në ato kohë të vështira.  - Gjykojnë për pasojat që solli L.D.B. për njerëzimin në përgjithsi dhe për Holokaustin në veçanti.

<p><b>V. KOHA BASHKËKOHORE</b></p>	<p><b>3. Bota gjatë Luftës së Dytë Botërore</b></p>	<p><b>Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore</b> Shqipëria nën pushtimin italian fashist (1939-1943).</p> <p>Shqipëria nën pushtimin nacist gjerman (1943-1945)</p> <p>Çlirimi i Shqipërisë dhe rrjedhojat e luftës çlirimtare antifashiste.</p> <p>Lufta antifashiste në Kosovë gjatë viteve 1941–1944 dhe ripushtimi jugosllav i saj</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>- Janë në gjendje të shpjegojnë për pozitën e vështirë të Shqipërisë dhe pushtimin e saj nga fashistët italian dhe nazizmi gjerman.</p> <p>- Çmojnë LNÇ dhe rëndësinë që pati kjo luftë për të ardhmen e popullit shqiptar.</p> <p>- Analizojnë luftën antifashiste në Kosovë dhe rrethanat e ripushtimit jugosllav të saj.</p>	<p>Gjeografinë, ekonominë, letërsinë, artin etj.</p>
<p><b>V. KOHA BASHKËKOHORE</b></p>	<p><b>4. Bota pas Luftës së Dytë Botërore</b></p>	<p><b>Bota pas Luftës së Dytë Botërore</b> SHBA, BRSS, Evropa Perëndimore, Vendet e Evropës Lindore pas L.D. B. e deri në fund të shekullit XX.</p> <p>Acarimi i marrëdhënieve ndërkombëtare – Lufta e Ftohtë.</p> <p>Azia, Afrika dhe Amerika Latine pas L.D.B.</p> <p><b>(6 orë)</b></p>	<p>- Mund të diskutojnë në mënyrë të argumentuar për zhvillimet kryesore shoqërore, ekonomike e politike në SHBA, BRSS, Evropë Perëndimore e Lindore pas L.D.B.</p> <p>- Identifikojnë organizatat dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare me karakter botëror, evropian e regional, si OKB, NATO, Këshilli i Evropës, Bashkësia Evropiane etj dhe çmojnë rolin e tyre.</p> <p>- Krahasojnë dallimet dhe specifikat mes shteteve kryesore.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë, fizikën, kiminë, artin, muzikën etj.</p>

			- Mund të rangojnë zhvillimet kryesore në Azi, Afrikë, dhe Amerikën Latine.	
<b>V. KOHA BASHKËKOHORE</b>	<b>5. Të arriturat në kulturë, shkencë e në teknikë gjatë shekullit XX</b>	<b>Kultura, shkenca, teknika</b> Zhvillimi i kulturës, i shkencës dhe i teknikës pas L.D.B. në botë.  <b>(1 orë)</b>	- Vlerësojnë të arriturat kulturore, shkencore e teknike dhe ndikimet e tyre në jetën e përditshme të njerëzve.	Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë, fizikën, kiminë, artin, muzikën etj.
<b>V. KOHA BASHKËKOHORE</b>	<b>4. Bota pas Luftës së Dytë Botërore</b>	<b>Shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore</b> Shqipëria në periudhën e diktaturës komuniste (1944-1990).  Përmbysja e komunizmit në Shqipëri dhe ngadhënjimi i demokracisë.  Kosova dhe viset e tjera shqiptare pas L.D.B. e deri në vitin 1989.  Shpërbërja e Jugosllavisë dhe lufta e shqiptarëve për liri e pavarësi.  Lufta e UÇK-së, ndërhyrja ndërkombëtare dhe çlirimi i Kosovës.  <b>(5 orë)</b>	- Analizojnë dhe gjykojnë në mënyrë kritike për zhvillimet e gjithmbarshme gjatë regjimit komunist në Shqipëri.  - Vlerësojnë dhe çmojnë përmbysjen e komunizmit në Shqipëri dhe ngadhënjimin e demokracisë.  - Mund të shpjegojnë në mënyrë të argumentuar për momentet e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe për ve ndimet e rëndësishme të shqiptarëve në Kosovë për liri dhe pavarësi  - Vlerësojnë në mënyrë të argumentuar arsyet e daljes në skenë të	Gjeografinë, ekonominë, shkencat juridike, letërsinë, gjuhën, artin, muzikën etj.

			UÇK-së, luftën e saj çlirimtare, ndërhyrjen e bashkësisë ndërko-mbëtare dhe çlirimin e Kosovës.	
--	--	--	---	--

**Vërejtje:** 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që, sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve, të kenë mundësi të zgjedhinr ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni, vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, instituteve, monumenteve etj.)



## **GJIMNAZI I SHKENCAVE SHOQËRORE**

### **Qëllimet**

#### ***Programi mësimor i lëndës së historisë për klasën XI ka për qëllim:***

- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të kuptuar dhe për të analizuar ligjshmëritë e proceseve shoqërore, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë njerëzore nga mesjeta e deri në Luftën e Parë Botërore.
- Zhvillimin e aftësive të nxënësve për të analizuar dhe për të krahasuar mënyrën e jetesës, të menduarit, zhvillimin ekonomik, politik, shoqëror, të të arriturave shkencore nga mesjeta deri në dekadat e para të shekullit XX
- Aftësimin e nxënësve për të analizuar rolin e personaliteteve që kanë lënë gjurmë në histori si dhe të momenteve që ndikuan në kahet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.
- Zhvillimin e të gjykuarit drejt për shkaqet, rrjedhojat dhe pasojat e luftërave, ndryshimet shoqërore që sollën revolucionet etj.

### **Objektivat e përgjithshëm dhe specifikë**

#### ***Nxënësit duhet të jenë në gjendje:***

##### ***Të njohin***

- Kronologjinë e zhvillimeve të ngjarjeve më kryesore nga historia e vendit, rajonit dhe e botës që nga Mesjeta e deri te Lufta e Parë Botërore.
- Proceset dhe ligjshmërit e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore ekonomike, politike, kulturore, religjioze etj

##### ***Të kuptojnë***

- Domethëniet e termave historikë për këtë periudhë.
- Konceptet dhe parimet e zhvillimeve shoqërore prej Mesjetës e deri në Luftën e Parë Botërore.
- Rëndësinë e të arriturave shkencore dhe teknike që patë për prosperitetin e përgjithshëm të shoqërisë njerëzore në këtë periudhë.



### ***Të analizojnë***

- Dallimet mes periudhave historike, feudalizmit të zhvilluar e kapitalizmit.
- Faktorët që ndikuan në zhvillimet e proceseve shoqërore gjatë këtyre fazave.

### ***Të vlerësojnë***

- Rolin e shteteve dhe të institucioneve vendore e ndërkombëtare në avancimet e proceseve shoqërore.
- Ngjarjet historike që ndikuan negativisht në zhvillimin shoqëror, në mënyrë që ato të mospërsëriten.
- Kontributin e personaliteteve kryesore të vendit, rajonit dhe botës.

### ***Të zhvillojnë qëndrime dhe vlera***

- Vlerësimin e të arriturat dhe vlerat e shoqërisë njerëzore gjatë periudhës së feudalizmit dhe kapitalizmit.
- Sendërtojnë ndjenjën dhe nevojën e mirëkuptimit, bashkëpunimit dhe kultivimit të marrëdhënieve demokratike.
- Respektimin e dallimeve (klasore, gjinore, etnike, kulturore, religjioze etj.) në shoqëri.
- Për ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike, ruajtjen e monumenteve kulturo-historike, muzeve, arkivave, bibliotekave etj. si pasuri kombëtare e njerëzore në përgjithësi.

**GJIMNAZI I SHKENCAVE SHOQËRORE 3 x 35 = 105 orë në vit (82 orë zhvillim, 4 orë në dispozicion dhe 19 orë përsëritje)**

<b>Kategoria</b>	<b>Nënkategoria</b>	<b>Përmbajtjet programore</b>	<b>Rezultatet e pritura</b>	<b>Ndërlidhjet programore</b>
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>2. Zbulimet e mëdha gjeografike</b>	<p><i>Nxënësit mësojnë për:</i></p> <p><b>Zbulimet e mëdha gjeografike dhe rëndësia e tyre</b> Zbulimet e mëdha gjeografike. Fillimet e kolonializmit evropian. Rrjedhojat e zbulimeve gjeografike.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p><i>Nxënësit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxjerrin përfundime dhe janë në gjendje të komentojnë arsyet dhe rrethanat që ndikuan në zbulimet gjeografike.</li> <li>- Dallojnë kolonitë e para që i krijuan në atë kohë vendet e fuqishme evropiane.</li> <li>- Gjykojnë në mënyrë kritike për rëndësinë dhe pasojat pozitive e negative që patën zbulimet.</li> </ul>	<p><i>Me:</i></p> <p>Gjeografinë, fizikën, matematikën, biologjinë etj.</p>
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>1. Rilindja, reforma dhe kundërreforma</b>	<p><b>Reformacioni dhe kundërreforma katolik</b> Reformacioni në Gjermani Reformacioni në vende të tjera të Evropës. Kundërreformacioni katolik.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë se shitja e indulgjencave dhe një varg arsyesish të tjera ishin shkaqet që ndikuan në përhapjen e ideve reformiste në kishë.</li> <li>- Dallojnë karakteristikat e këtyre reforma në vendet e ndryshme evropiane.</li> <li>- Mund të komentojnë për veprimtarinë e personaliteteve si Martin Luteri, Zhan Kalvini etj.</li> </ul>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, artin etj.</p>

<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>3. Evropa gjatë kohës së re</b></p>	<p><b>Evropa në shekullin XVI e deri në mesin e shekullit XVII</b> Formimi i Monarkisë Habsburge.</p> <p>Spanja në kohën e Filipit II dhe Revolucioni në Vendet e Ulëta.</p> <p>Franca në periudhën e absoluti zmit.</p> <p>Anglia në shekullin XVI dhe në fillim të shekullit XVII. Revolucioni Borgjez në Angli.</p> <p>Të arriturat në kulturë e në shkencë në shekullin XVI-XVII.</p> <p>Republika e Raguzës dhe qytetet bregdetare.</p> <p>Marrëdhëniet ndërkombëtare në shekullin XVI-XVII.</p> <p><b>(7 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë zhvillimet e përgjithshme, dallojnë karakteristikat specifike dhe analizojnë ngjarjet më të rëndësishme në vendet kryesore evropiane (Mbretërinë e Habsburgve, Spanjë, Francë, Angli, Raguzë etj)</li> <li>- Mund të diskutojnë për karakteristikat e absolutizmit francez dhe zhvillimet e revolucionit borgjez anglez në atë kohë.</li> <li>- Veçojnë e vlerësojnë të arriturat kryesore në kulturë e në shkencë dhe ndikimet e tyre në jetën e përditshme të njerëzve.</li> <li>- Analizojnë në aspektine e përgjithshëm marrëdhëniet ndërkombëtare dhe nxjerrin përfundime për reflektimet e këtyre marrëdhënieve në historinë e mëvonshme.</li> </ul>	<p>Letërsinë, gjeografinë, edukatën qyte tare etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b></p>	<p><b>Arsimi, kultura, shkenca.</b> Të arriturat në kulturë e në shkencë në shekullin XVI-XVII në Evropë.</p> <p><b>(1 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veçojnë e vlerësojnë të arriturat kryesore në kulturë e në shkencë dhe ndikimet e tyre në jetën e përditshme të njerëzve.</li> </ul>	<p>Letërsinë, gjeografinë, edukatën qyte tare, artin, muzikën, filozofinë, teknologjinë etj.</p>

<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Administrata e pushtetit osman në Ballkan, qëndresa e shqiptarëve gjatë shekujve XVI - XVII</b> Organizimi politik – administrativ dhe ekonomik osman.</p> <p>Qëndresa shqiptare në shekullin XVI.</p> <p>Kuvendet shqiptare e ballkanike për luftë të përbashkët kundër sundimit osman.</p> <p>Lëvizja çlirimtare të popujt e Ballkanit.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>- Mund të shpjegojnë formën e organizimit politik, administrativ e ekonomik që vendosi Perandoria Osmane në Ballkan.</p> <p>- Në mënyrë të argumentuar diskutojnë për qëndresën e popullit shqiptar dhe mund të japin sqarime për vendimet dhe ndikimet e kuvendeve shqiptare e ballkanike.</p> <p>- Vlerësojnë lëvizjet çlirimtare të popujve të Ballkanit.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b></p>	<p><b>Besimi e kultura të shqiptarët gjatë shekujve XVI - XVII</b> Ndryshimet në strukturën fetare të popullit shqiptar.</p> <p>Zhvillimi i kulturës në trojet shqiptare gjatë shekujve XVI – XVII.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<p>- Në mënyrë të argumentuar shpjegojnë arsyet e ndryshimit të strukturës fetare të popullit shqiptar.</p> <p>- Mund të radhisin të arriturat kryesore kulturore dhe ndikimet e tyre.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, edukatën qytetare, artin etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>3. Evropa gjatë Kohë së Re</b></p>	<p><b>Evropa në gjysmën e dytë të shekullit XVII dhe në shekullin e XVIII</b></p>	<p>- Mund të shpjegojnë në mënyrë të argumentuar pasojat e luftërave austriako – osmane në përgjithësi e për Ballkanin në</p>	<p>Edukatën qytetare, gjeografinë,</p>

		<p>Dobësimi i Perandorisë Osmane dhe luftërat Austriako-osmane në vitet 1683-1699.</p> <p>Zhvillimi i qyteteve në Evropë</p> <p>Rusia në fund të shekullit XVII dhe në fillim të shekullit XVIII.</p> <p>Revolucioni industrial në Angli.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>veçanti.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikojnë ndryshimet kryesore në qytetet evropiane të asaj kohe.</li> <li>- Dallojnë ngjarjet dhe zhvillimet kryesore politike, ekonomike e shoqërore në Rusinë e asaj kohe.</li> <li>- Në mënyrë të argumentuar mund të sqarojnë për ndikimet e revolucionit industrial në Angli.</li> </ul>	artin etj
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b>	<p><b>Idetë e reja përparimtare, shkenca dhe teknika</b></p> <p>Zhvillimi i kulturës e i shkencës.</p> <p>Iluminizmi, lindja dhe zhvillimi i tij.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikojnë të arriturat kryesore në kulturë e në shkencë</li> <li>- Në mënyrë kritike gjykojnë për rëndësinë e lindjes dhe të përhapjes së ideve iluministe.</li> </ul>	Edukatën qytetare, gjeografinë, artin, filozofinë, sociologjinë etj
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë Kohës së Re</b>	<p><b>Vendet e Azisë gjatë shekujve XVI -XVIII</b></p> <p>India në shekujt XVII -XVIII</p> <p>Kina dhe Japonia në shekujt XVII-XVIII.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Dallojnë ngjarjet kryesore në këto vende dhe mund të vlerësojnë ndikimet e tyre në rrjedhojat e përgjithshme botërore.</li> </ul>	Gjeografinë, letërsinë, artin etj.

<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b></p>	<p><b>Kultura</b> Zhvillimi i kulturës në Indi e në Kinë dhe në Japoni gjatë shekujve XVI-XVIII.</p> <p><b>(1 orë)</b></p>	<p>- Identifikojnë zhvillimet kryesore kulturore në këto vende, karakteristikat e tyre dalluese dhe ndikimet e tyre.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë, artin, folozofinë etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Sthurja e sistemit feudal osman dhe pashallëqet e mëdha shqiptare</b> Ndryshimet ekonomiko-shoqërore te shqiptarët në shekujt XVII-XVIII.</p> <p>Pashallëku i Shkodrës.</p> <p>Pashallëku i Janinës.</p> <p>Marrëdhënjet e pashallëqeve shqiptare me fqinjët dhe shtetet evropiane.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>- Kuptojnë ndryshimet shoqërore –ekonomike që ndodhën në atë kohë te shqiptarët</p> <p>- Mund të diskutojnë për rrethanat e krijimit të pashallëqeve shqiptare, zhvillimet kryesore në to dhe raportet mes tyre.</p> <p>- Mund të komentojnë për marrëdhëniet e pashallëqeve shqiptare me fqinjët dhe vendet e tjera evropiane, veçanërisht raportet e Ali Pash Tepelenës me Napoleon Bonopartën.</p>	<p>Letërsinë, edukatën qytetare, ekonominë, gjeografinë, artin etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b></p>	<p><b>Kultura te shqiptarët</b> Kultura shqiptare gjatë shekujve XVII, XVIII dhe në fillim të shekullit XIX.</p> <p><b>(1 orë)</b></p>	<p>- Dallojnë dhe vlerësojnë të arriturat kulturore te shqiptarët në atë kohë.</p>	<p>Letërsinë, edukatën qytetare, ekonominë, gjeografinë, artin etj</p>

<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë kohë së re</b></p>	<p><b>Lufta kundër kolonializmit dhe formimi i SHBA-ve</b> Lufta kundër anglezëve dhe shpallja e pavarësisë së SHBA-së</p> <p>Kushtetuta e SHBA-së (1787)</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arsyetojnë në mënyrë të argumentuar luftën e drejtë të amerikanëve kundër anglezëve.</li> <li>- Vlerësojnë rolin e personaliteteve amerikane (Xh.Uashingtonit, T. Xhefersonit, B.Franklin etj.) në shpalljen e pavarësisë së SHBA-ve.</li> <li>- Veçojnë rolin dhe ndikimin e Kushtetutës amerikane të vitit 1787 në avancimin e organizimeve shtetërore dhe trajtimin e të drejtave të njeriut.</li> </ul>	<p>Gjeografinë, letërsinë, artin, edukatën qytetare etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>3. Evropa gjatë kohë së re</b></p>	<p><b>Revolucioni Borgjez Francez</b> Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe e Qytetarëve dhe shpallja e Republikës.</p> <p>Periudha e Diktaturës Jakobine.</p> <p>Franca në kohën e Napoleon Bonapartës.</p> <p>Rënia e Perandorisë së Napoleon Bonapartës.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veçojnë dhe argumentojnë rrethanat që ndikuan në shpërthimin e Revolucionit.</li> <li>- Kuptojnë dhe mund të përgjithësojnë ndikimin pozitiv që patën Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarëve dhe shpallja e Republikës për progresin e njerëzimit në përgjithësi.</li> <li>- Identifikojnë momentet kryesore të periudhës së Diktaturës Jakobine.</li> <li>- Mund të lidhin veprimet kryesore politike e ushtarake të Napoleonit me ndryshimet gjeopolitike në Evropë.</li> <li>- Identifikojnë rrethanat e rënies së Perandorisë së Napoleonit.</li> </ul>	<p>Edukatën qytetare, gjeografinë, letërsinë etj.</p>

<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>3. Evropa gjatë kohë së re</b>	<p><b>Evropa gjatë viteve 1814 – 1848</b> Kongresi i Vjenës dhe Aleanca e Shenjtë.</p> <p>Anglia pas Kongresit të Vjenës e deri më 1848.</p> <p>Franca pas Kongresit të Vjenës e deri më 1848.</p> <p>Gjermania pas Kongresit të Vjenës e deri më 1848.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<p>- Kuptojnë vendimet e Kongresit të Vjenës (1814) dhe ndikimin e këtyre vendimeve në ndryshimet gjeopolitike në Evropën e asaj kohe.</p> <p>- Mund të përshkruajnë situatën e gjithmba rshme në shtetet kryesore evropiane.</p>	Gjeografinë, shkencat juridike etj.
		<p><b>Revolucioni i vitit 1848 në Evropë</b> Revolucioni i vitit 1848 në Francë e në Gjermani.</p> <p>Revolucioni i vitit 1848 në Austri e Hungari.</p> <p>Revolucioni i vitit 1848 në Itali.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p>- Dallojnë rrjedhat dhe karakteristikat e revolucionit nëpër vendet e ndryshme të Evropës.</p> <p>- Nxjerrin përfundime për ndikimet që pati revolucionit në shoqërin evropiane të asaj kohe.</p>	Gjeografinë, ekonominë etj.



<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>3. Evropa gjatë Kohës së Re</b></p>	<p><b>Vendet e Evropës deri në fund të viteve '80 të shekullit XIX</b>  Franca në periudhën e Perandorisë së Dytë.</p> <p>Bashkimi i Gjermanisë.  Bashkimi i Italisë.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p>- Vlerësojnë gjendjen e përgjithshme në shtetet kryesore evropiane dhe mund të krahasojnë karakteristikat dalluese mes tyre.</p> <p>- Vlerësojnë bashkimin e Gjermanisë dhe bashkimin e Italisë dhe nxjerrin përfundime për ndikimet që patën këto bashkime në arenën ndërkombëtare.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, teknologjinë etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë kohës së re</b></p>	<p><b>SHBA-të, Rusia në gjysmën e dytë të shekullit XIX</b>  Lufta civile në SHBA.</p> <p>Rusia deri në fundin e viteve '80 të shekullit XIX.</p> <p><b>(2 orë)</b></p>	<p>- Vlerësojnë gjendjen e përgjithshme në këto dy vende dhe mund të krahasojnë karakteristikat dalluese mes tyre.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, teknologjinë etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Perandoria Osmane dhe Ballkani gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX</b>  Perandoria Osmane gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>Ballkani gjatë viteve të Krizës Lindore.  Krijimi i shteteve të pavarura të Ballkanit.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p>- Mund të shpjegojnë në mënyrë të përgjithshme situatën në Perandorinë Osmane dhe ndikimet e tyre në Ballkan.</p> <p>- Gjykojnë drejt për momentet e krijimit të shteteve të pavarura ballkanike.</p> <p>- Analizojnë arsyet e shpërthimit të luftërave ballkanike dhe ndryshimet që sollën ato në Ballkan.</p>	<p>Gjeografinë, edukatën qytetare, letërsinë etj.</p>

<p><b>V. KOHA BASHKËKOH ORE</b></p>	<p><b>1. Bota në fillim të shekullit XX</b></p>	<p>Luftërat ballkanike. <b>(1 orë)</b></p>	<p>- Analizojnë arsyet e shpërthimit të luftërave ballkanike dhe ndryshimet që sollën ato në Ballkan.</p>	<p>Gjeografinë, letërsinë etj.</p>
<p><b>IV. KOHA E RE</b></p>	<p><b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b></p>	<p><b>Lëvizja kombëtare shqiptare nga vitet `30 të shekullit XIX e deri më 1881</b> Shqiptarët në periudhën e Tanzimatit.  Ndryshimet në jetën ekonomike shoqërore në trevat shqiptare.  Fillet e Rilindjes Kombëtare- iluministët e parë.  Kriza Lindore dhe rreziku i copëtimit të tokave shqiptare.  Formimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.  Lufta e Lidhjes së Prizrenit për Autonomi dhe acarimi i marrëdhënieve me Portën e Lartë 1878-1879.  Lufta e Lidhjes për ruajtjen e tërësi së tokave shqiptare.  Formimi i Qeverisë së përkohë-</p>	<p>- Kuptojnë drejt ndikimet e Tanzimatit në jetën e popullit shqiptar në atë kohë.  - Analizojnë shkaqet kryesore të thellimit të krizës në Perandorinë Osmane.  - Dallojnë iluministët më të shquar shqiptarë dhe idetë e tyre për platformën kombëtare.  - Vlerësojnë rëndësinë historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe luftën e saj për autonomi.  - Dallojnë personalitetet kryesore të Lidhjes së Prizrenit dhe rolin e tyre.  - Në mënyrë të argumentuar mund të sqarojnë për rrethanat dhe shkaqet e shkatërrimit të Lidhjes së Prizrenit.</p>	<p>Letërsinë, gjeografinë, edukatën qytetare etj.</p>

		<p>shme dhe veprimtaria e saj deri në prill të vitit 1881.</p> <p><b>(8 orë)</b></p>		
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>3. Evropa gjatë Kohë së Re</b>	<p><b>Evropa në fund të shekullit XIX e deri në fillim të shekullit XX</b> Anglia dhe Franca në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>Italia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>Austro-Hungaria në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p>Kuptojnë zhvillimet e përgjithshme të Evropës së asaj kohe.</p> <p>Kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet e organizimit shoqëror e shtetëror të shteteve kryesore në atë kohë.</p> <p>Shpjegojnë për të arriturat shkencore, zhvillimet politike, ekonomike e kulturore dhe ndikimin e tyre në progresin e përgjithshëm njerëzor.</p>	Gjeografinë, ekonominë, teknologjinë, letërsinë, artin etj.
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>5. Azia, Afrika dhe Amerika gjatë Kohë së Re</b>	<p><b>Bota në fund të shekullit XIX e deri në fillim të shekullit XX</b> Rusia në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p>SHBA-të pas luftës civile.</p> <p>Azia, Afrika dhe Amerika Latine në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX.</p> <p><b>(3 orë)</b></p>	<p>Kuptojnë zhvillimet e përgjithshme të botës së asaj kohe.</p> <p>Kuptojnë ngjashmëritë dhe dallimet e organizimit shoqëror e shtetëror të shteteve kryesore në atë kohë.</p>	Gjeografinë, ekonominë, teknologjinë, letërsinë, artin etj.

<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b>	<b>Kultura, shkenca</b> Të arriturat në kulturë, në shkencë e në teknikë në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.  <b>(1 orë)</b>	Shpjegojnë për të arriturat shkencore, zhvillimi met politike, ekonomike e kulturore dhe ndikimin e tyre në progresin e përgjith- shëm njerëzor.	Gjeografinë, ekonominë, teknologjinë, letërsinë, artin etj.
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>4. Perandoria Osmane dhe Ballkani</b>	<b>Lëvizja Kombëtare Shqiptare gjatë viteve 1881-1900</b>  Lidhja Shqiptare e Pejës (1899).  <b>(1 orë)</b>	- Kuptojnë rrethanat e gjithmbarshme në të cilat u formua Lidhja Shqiptare e Pejës.  - Identifikojnë personalitetet më të dalluara si Haxhi Zeka etj.  - Kuptojnë platformën e Lidhjes dhe shkaqet e shpërndarjes së saj.	Gjeografinë, letërsinë etj.
<b>IV. KOHA E RE</b>	<b>6. Arsimi, kultura, shkenca dhe teknika</b>	<b>Arsimi, kultura</b> Zhvillimi i arsimit dhe i kulturës në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.  <b>(1 orë)</b>	- Vlerësojnë të arriturat më të rëndësishme në atë kohë.	Gjeografinë, letërsinë, artin etj.
<b>V. KOHA BASHKËKOH ORE</b>	<b>1. Bota në fillim të shekullit XX</b>	<b>Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1900-1912 dhe Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë</b> Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 1900-1908.	- Kuptojnë vazhdimin e përpjekjeve të shqiptarëve me të gjitha format për çlirim dhe formimin e shtetit.	Gjeografinë, letërsinë, artin etj.

		<p>Revolucioni i turqve të rinj dhe shqiptarët.</p> <p>Kryengritjet shqiptare të viteve 1909 – 1911.</p> <p>Kryengritja e përgjishme e vitit 1912.</p> <p>Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.</p> <p><b>(5 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë ndikimin e Revolucionit të turqve të rinj në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.</li> <li>- Konkludojnë për rëndësinë e vendimeve të Kongresit të Manastirit dhe të Elbasanit.</li> <li>- Gjykojnë në mënyrë kritike rolin e personaliteteve kryesore, si: Ismail Qemali, Isa Boletini, Luigj Gurakuqi, Hasan Prishtina etj.</li> </ul>	
<b>V. KOHA BASHKËKOH-ORE</b>	<b>1. Bota në fillim të shekullit XX</b>	<p><b>Shteti i pavarur shqiptar në vitet 1912-1914</b></p> <p>Veprimtaria e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës e kryesuar nga Ismail Qemali.</p> <p>Caktimi i kufijve dhe njohja e Pavarësisë së Shqipërisë.</p> <p>Lufta për çlirim e bashkim kombëtar në viset e pushtuara nga Greqia, Serbia e Mali i Zi (1912-1914).</p> <p>Shqipëria gjatë sundimit të Princit Vilhem Vidi.</p> <p><b>(4 orë)</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjykojnë në mënyrë kritike veprimtarinë e Qeverisë së Ismail Qemali.</li> <li>- Janë në gjendje të shprehin qëndrimet e veta për vendimet e Konferencës së Londrës dhe pasojat e tyre.</li> <li>- Konkludojnë për rëndësinë e njohjes së pava rësisë së Shqipërisë.</li> <li>- Kuptojnë arsye të luftës së shqiptarëve në viset e pushtuara</li> <li>- Analizojnë rrethanat në të cilat qeveris princ Vilhem Vidi dhe shkaqet kryesore të largimit të tij.</li> </ul>	Shkencat juridike, ekonominë, gjeografinë, letërsinë etj.

**Vërejtje:** 4 orë mësimore mbesin në dispozicion të arsimtarit që, sipas dëshirës dhe interesimit të nxënësve, të kenë mundësi të zgjedhin ndonjë njësi mësimore në kuadër të përmbajtjeve programore, historisë lokale etj. Mund të realizohet edhe vizitë ndonjë institucioni-vendi kulturo-historik (arkivave, muzeve, bibliotekave, Instituteve, monumenteve etj.



## METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodologjia e mësimdhënies përcakton suksesin e realizimit të qëllimeve dhe të objektivave që mësimdhënësi ia paracakton vetes në bazë të përmbajtjeve programore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së vetë nxënësve. Prandaj, gjatë një ore mësimore, mësimdhënësi mund të përdorë disa forma, teknika, dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën në mënyrë që të arrijë rezultate optimale gjatë procesit mësimor. Duke synuar përmbushjen e kërkesave për nxenie cilësore me nxënësin në qendër sugjerohen, metoda, forma dhe teknika të tilla si:

### Format kryesore të organizimit të procesit mësimor janë:

*Puna me gjithë klasën,*  
*Puna me grupe* (të mëdha ose të vogla)  
*Puna me çifte*  
*Puna individuale*

### Metodat:

*E mësimdhënies* -(kallëzimi, shpjegimi, ligjërata, biseda, demonstrimi etj.)  
*E të mësuarit* - është metodë e punës së përbashkët e mësimdhënësit dhe nxënësve dhe përdoret për arritjen e qëllimeve, synimeve, qëllimeve, objektivave etj,  
*E të nxënësve*-(vrojtimi i pavarur, ushtrimet, diskutimet, debatet, shfrytëzimi i literaturës, shkëmbimi i mendimeve etj.)  
*Kërkimore* - është metodë që mundëson të bëhen kërkime historike përmes burimeve dhe analizave lidhur me saktësinë dhe interpretimin e fakteve të gjetura.

### Teknikat:

Ekziston numër i madh teknikash të mësimdhënies dhe të nxënies. Këtu sugjerohen vetëm disa sosh.

- **Brainstormingu** (“**stuhi, mendimesh**“, **gjenerim të ideve**)- është teknikë efektive që më tepër përdoret në fillim të orës mësimore.
- **Kllasteri (grumbulli apo pema e mendimeve)** - nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar. Rëndom shërben për të krijuar lidhje midis fakteve.
- **INSERT-i** - (është sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe për lexim të efektshëm). Kjo teknikë përdoret në pjesën kryesore dhe është efektive, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që lexon.
- **Pesëvargëshi** – është teknikë e veçantë që ka pesë vargje e cila kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet që përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të te



mës.

**-Xhigsou (Ndërthurja)** – është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Teknika të tjera janë: **ditari dypjesësh, di dua të dijë mësova, ese 5 dhe 10, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit shkrimi i lirë etj .**

**Historia gojore është gjithashtu një ndër mënyrat bashkëkohore të të mësuarit të lëndës së historisë.**

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave apo teknikave mësimore të lartpërmendura duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve përkatëse didaktike, pa të cilat nuk mund të arrihen rezultate e dëshiruara. Për tema mësimore të caktuara mund të shfrytëzohen me sukses muzetë, galeritë, bibliotekat, arkivat, ekskursionet në vendet dhe monumentet kulturo- historike etj.

## V L E R Ë S I M I

Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, i analizës dhe i interpretimit të informatave me qëllim përcaktimi se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëheqës.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe u shërben disa qëllimeve të ndryshme.

Ndër qëllimet kryesore të vlerësimit janë:

1. Të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve.
2. T`u sigurojë nxënësve informacion mësimor.
3. T`i motivojë nxënësit.
4. Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuara.
5. Të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

## T i p a t e v l e r ë s i m i t

Ekzistojnë tipa të larmishëm vlerësimi si:

- **Vlerësimi diagnostikues** përcakton te nxënësit dobësitë, vështirësitë, problemet dhe identifikon nxënësit me nevoja të veçanta.
- **Vlerësimi formues** ka për qëllim ta udhëzojë mësuesin në planifikim dhe te nxënësit të identifikojë vështirësitë gjatë nxënies (punës) me qëllim t`u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- **Vlerësimi klasifikues** ka për qëllim të caktojë pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotuar para parake dhe objektivat e parashikuara.
- **Vetëvlerësimi** është proces i mbledhjes, i analizës, i interpretimit të informatave dhe vepr-

mtarisë që nxënësi e bënë vetë me anë të ndonjë mjeti vlerësues.

- **Vlerësimi përmbledhës** bëhet me qëllim të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies p.sh. pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.
- **Vlerësimi në bazë të kritereve** kupton vlerësimin e çdo nxënësi që përmbush kriteret e caktuara p.sh. krahasimi i pikëve të testit me një standard të caktuar. Ky vlerësim i siguron informacion mësimdhënësit të identifikojë vështirësitë e nxënësit dhe të ndihmojë në përmirësimin e tyre.
- Vlerësimi **formues** dhe **diagnostikues** nuk vlerëson me nota, por në bazë të tyre mësimdhënësi planifikon punën e tij.
- **Vlerësimi i brendshëm** përfshin planin mësimor. Veprimtaria vlerësuese formulohet, zhvillohet dhe vlerësohet nga mësuesi.
- **Vlerësimi i jashtëm.** Veprimtaritë vlerësuese hartohen jashtë shkollës (specialistë të nivelit të lartë).
- **Vlerësimi i përditshëm** mbështetet në kontrollin e punës së nxënësit në klasë.
- **Vlerësimi paraprak** bëhet para testimit vlerësues.
- **Vlerësimi përfundimtar** bëhet në fund të vitit dhe mbështetet në vlerësimin përfundimtar të një lënde të caktuar.
- **Vlerësimi në proces** mbështetet në vlerësimin e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj.

## **V e p r i m t a r i t ë k r y e s o r e t ë v l e r ë s i m i t n ë k l a s ë**

- **Kontrolli i rëndomtë i veprimtarive në klasë**
- **Detyrat e shtëpisë**
- **Testet**

- Mësimdhënësi gjatë orës mësimore i **kontrollon** rregullisht nxënësit, u jep informacione për të lehtësuar nxënien dhe vazhdimisht kupton përparimin e nxënësve dhe vështirësitë e tyre.

- Rëndësia e **detyrave të shtëpisë** është se përmes tyre sigurohen informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë. Në rast të paraqitjes së vështirësive ndihma e prindit është e dobishme, por njëherësh mund të jetë edhe e padobishme nëse në vend që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës, nxënësi i merr të gatshme nga prindi.

### **Format e testeve janë:**

- Me gojë
- Me shkrim
- Përmes paraqitjes grafike etj.

Testimet janë të rëndësishme për të siguruar informacione për përparimin e nxënësit, por në raste të veçanta mund të ketë edhe anët negative për arsye se te nxënësit shkaktojnë ankth, stres, frikë etj. Gjatë zbatimit të testimit, sistemi i poentimit zgjidhet nga vetë mësimdhënësi.

Për vlerësimin e njohurive të nxënësve përdorim edhe veprimtari të tjera, p.sh.

- Vlerësimi i eseve
- Vlerësimi me dosje
- Vetëvlerësimi etj

## **BURIMET DHE MJETET MËSIMORE:**

1. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Prishtinë, 1997
2. Aspekte të mësimdhënies së historisë, Tiranë, 1995
3. Bardhyl Musai, Psikologjia e Edukimit, Shtëpia Botuese: Pegi, Tiranë, 1999
4. Bardhyl Musai, Metodologjia e Mësimdhënies, Tiranë, 2003
5. Grup autorësh, Të kuptojmë të kaluarën e përbashkët për të ndërtuar të ardhmen, Ndryshime dhe vazhdimësi të jetës së përditshme në Shqipëri, Bullgari dhe Maqedoni 1945 – 2000, botues: EUROCLIO, Shoqata e Mësuesve të Historisë të Shqipërisë, Shoqata Bullgare e Mësuesve të Historisë, Shoqata e Historianëve të Republikës së Maqedonisë, Tiranë, 2003
6. Historia e Popullit Shqiptar I, Tiranë, 2001
7. Historia e Popullit Shqiptar II, Tiranë, 2001
8. Dr. Bep Jubani, Dr. Isa Bicaj, Dr. Vilson Kuri, HISTORIA për klasën e parë të shkollave të mesme, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
9. Dr. Fehmi Rexhepi, Dr. Isa Bicaj, HISTORIA për klasën e parë të shkollave të mesme profesionale, Shtëpia Botuese Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
10. Grup autorësh, Historia e Popullit Shqiptar, për shkolla të mesme, botoi : Libri Shkollor, Prishtinë, 1998
11. Grup autorësh, Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve, nën redaktimin e prof. Dr. Hysni Myzyrit, botoi: Siprinti, Prizren, 2000
12. Dr. Agron Gani, Dr. Hysni Myzyri, Dr. Jusuf Bajraktari, Historia për klasën e dytë të shkollave të mesme. botoi: Libri Shkollor, Prishtinë, 2001
13. Mikel Pjetrush, Atlas historik i botës, Shtëpia Botuese Camaj – Pipa, Shkodër, 2001
14. MASHT, Plani dhe programi mësimor 9, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002
15. MASHT, Plani dhe programi mësimor 10, Libri Shkollor, Prishtinë, 2003

### **Burimet në internet:**

16. [www.dadalos.org](http://www.dadalos.org)
17. [www.historyplace.com](http://www.historyplace.com)
18. [www.see-educoop.net](http://www.see-educoop.net)
19. [www.eurocliohistory.org](http://www.eurocliohistory.org)
20. [www.euroclio.net](http://www.euroclio.net)

